VENDIM
Nr. 93, datë 6.8.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.61, DATË 2.11.2007 "PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.8.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë HERA sh.p.k. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.61, datë 2.11.2007 "Për dhënien e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike" dhe konsideroi të drejtë kërkesën e shoqërisë HERA sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.61, datë 2.11.2007 "Për dhënien e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike" bëhen këto ndryshime:

- në pikën 1, afati prej 9 muajve ndryshohet dhe bëhet 15 muaj,
- në pikën 4, afati prej 36 muajve ndryshohet dhe bëhet 42 muaj.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.61, datë 2.11.2007.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta